

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 237/prot.  
7

Tiranë, më 30.9. 2024

Lënda: Raporti i Monitorimit për 8-mujorin e vitit 2024

MINISTRISË SË FINANCAVE  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

## I. Hyrje

Institucioni i Komisionerëve Publikë është institucion kushtetues i pavarur, i cili është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b, aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si organ i sistemit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim garantimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës dhe pavarësisë në sistemin e drejtësisë, si edhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 30.5.2023, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, është kryer monitorimi i zbatimit të buxhetit për Institucionin e Komisionerëve Publikë, për periudhën 8-mujore të vitit 2024.

## II. Informacioni buxhetor i përmbledhur

Në vijim paraqitet, në mënyrë të përmbledhur, realizimi i fondeve buxhetore për periudhën raportuese, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar.

Në mijë lekë

Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 8-mujor (plani)	Realizimi 8-mujor (fakti)	Realizimi në %
Shpenzime korente	113,400	115,400	81,400	68,426	84%
Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,500	-	-
<b>TOTALI</b>	114,900	116,900	82,900	68,426	83%

Me ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, u miratua buxheti total vjetor për Institucionin e Komisionerëve Publikë, në vlerën 114,900 mijë lekë, i detajuar në 101,200 mijë lekë në shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 12,200 mijë lekë në shpenzime operative dhe 1,500 mijë lekë në shpenzime kapitale (investime).

Gjatë kësaj periudhe, me kërkesë të institucionit dhe me miratimin e Ministrisë së Financave ky buxhet është rishikuar në shpenzime korente dhe pas ndryshimeve arriti në vlerën 108,300 mijë lekë në shpenzime personeli dhe 6,900 mijë lekë në shpenzime operative. Ndryshimet u realizuan me:

- Transferim të fondeve brenda shpenzimeve korente prej 5,300 mijë lekë, duke pakësuar shpenzimet operative dhe rritur buxhetin në paga dhe sigurime shoqërore, me qëllim mbulimin e një pjese të detyrimeve në sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat, për pagat e rillogaritura sipas vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese.

- Shtesë fondi në shpenzime personeli, për të mbuluar efektet financiare për periudhën e mbetur të vitit, për rritjen e pagave të specialistëve dhe punonjësve mbështetës të institucionit, në zbatim të vendimit nr. 421 datë 26.6.2024, dhe vendimit nr. 422, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, si dhe për të mbuluar efektet financiare prej datës 1 prill 2023, pas riklasifikimit të pagave për disa pozicione pune, në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 34/2024.

Gjithashtu, në muajin maj është çelur edhe fondi i veçantë për Institucionin e Komisionerëve Publikë prej 200,000 mijë lekë, mbështetur në udhëzimin plotësues nr. 1, datë 24.1.2024, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”.

Numri total i punonjësve në organikë i miratuar në ligjin e buxhetit është 30 punonjës dhe struktura organike dhe klasifikimi i pagave është sipas vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, i ndryshuar. Numri faktik i punonjësve në fund të 8-mujorit është 27 punonjës, për shkak të dorëheqjeve nga detyra dhe pamundësisë për rekrutim të punonjësve të rinj në përfundim të mandatit kushtetues institucional.

### III. Performanca e buxhetit sipas artikujve ekonomikë

Në mënyrë analitike, performancën e realizimit të shpenzimeve buxhetore për 8-mujorin e vitit 2024, për Institucionin e Komisionerëve Publikë, e gjeni të paraqitur në formë tabelore më poshtë:



Në mijë lekë

Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor (plani)	Buxheti vjetor i rishikuar (plani)	Buxheti 8-mujor (plani)	Realizimi 8-mujor (fakti)	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	101,200	108,300	76,500	65,979	86,2%
602+606	Shpenzime për mallra dhe shërbime, dhe fondi i veçantë	12,200	6,900	4,900	2,447	50 %
231	Shpenzime kapitale	1,500	1,500	1,500	0	0 %
	<b>TOTALI</b>	114,900	114,900	82,900	68,426	83%

**III.1. Artikulli 600 dhe 601, “Shpenzime personeli”**, buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit 2024, për këtë artikull, është 101,200 mijë lekë, buxhet i cili duhet të mbulonte sipas dispozitave ligjore në fuqi nevojat e institucionit në fushën e pagave për të gjithë vitin aktual.

Siç theksuam dhe më lart, nëpërmjet rialokimit brenda shpenzimeve korente u pakësuan shpenzimet operative dhe u shtuan shpenzimet në paga dhe sigurime shoqërore me 5,300 mijë lekë, buxhet i nevojshëm për mbulimin e një pjesë të shpenzimeve për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale si rezultat i ndryshimit të listëpagesave pas rillogaritjes së pagës për Komisionerët Publikë dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, sipas vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese. Për efektet e prapambetura si rezultat i rillogaritjes së pagës prej fillimit të aktivitetit të institucionit, janë kryer pagesat në fund të muajit dhjetor 2023 me buxhetin shtesë të miratuar për këtë qëllim, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 20.12.2023, “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj”. Meqenëse ndryshimi i listëpagesave (Esig) nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u krye në muajt shkurt dhe mars të këtij viti, me vendim të Mbledhjes së Komisionerëve Publikë, pagesat e detyrimeve shtesë në sigurime shoqërore e shëndetësore dhe Tap janë mbuluar me buxhetin e vitit 2024.

Përllogaritja e pagave për Komisionerët Publikë dhe Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor të Institucionit të Komisionerëve Publikë është bazuar në ligjin nr. 33/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”. Kategorizimi dhe përllogaritja e pagave për Njësine Administrative është në përputhje me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për punonjësit e Administratës së njësive të përgjithshme (VKM-në nr. 325, datë 31.5.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi

pagë të...” dhe VKM-në nr. 326, datë 31.5.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”).

Në muajin prill u miratua vendimi i Kuvendit nr. 34/2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, ‘Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe riklasifikimit të pagave të personelit të Komisionerëve Publikë’”, i ndryshuar, në të cilin kategorizimi i pagave për Njësinë Administrative është përshtatur me vendimet e sipërcituara të Këshillit të Ministrave, si dhe është miratuar kërkesa e institucionit për riklasifikimin e pagave për 3 pozicione pune. Për të mbuluar efektet financiare prej datës 1 prill 2023, pas riklasifikimit të pagave për disa pozicione pune, në zbatim të këtij vendimi, si dhe pas hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 421, datë 26.6.2024, dhe vendimit nr. 422, datë 26.6.2024, që miratuan rritjen e dytë të pagave të specialistëve dhe punonjësve mbështetës të institucionit, u alokua nga Ministria e Financave buxhet shtesë në shpenzime për paga e sigurime shoqërore prej 1,800 mijë lekë. Performanca e realizimit të këtij buxheti, në raport me planin e periudhës 8-mujore, është rreth 86%.

**III.2. Artikulli 602, “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”,** buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull, për vitin 2024, është 12,200 mijë lekë, i cili pas transferimit në shpenzime personeli, me 5,300 mijë lekë, siç u përmend edhe më lart, arriti në 6,900 mijë lekë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar disa procedura prokurimi, blerje me vlerë të vogël, si materiale pastrimi, kancelari, tonera dhe drume, mirëmbajtje UPS, blerje bileta udhëtimi, si dhe procedura të thjeshtuara, blerje materiale dhe shërbime, si: mirëmbajtje faqe *web*-i, shpenzime larje automjeti, abonime, mirëmbajtje automjeti etj.

Gjithashtu janë kryer shpenzime nga buxheti pa prokurim për dieta dhe shpenzime udhëtimi për takime jashtë vendit, në kuadër të procesit të negociatave me BE dhe shpenzime të zakonshme, shpenzime për energji, ujë, postë, taksat e Bashkisë, si dhe janë lidhur kontrata për parkim automjeti, telefoni celulare etj.

Në mënyrë analitike, shpenzimet operative për 8-mujorin janë realizuar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Në mijë lekë	
		Artikulli 602	
		Plan	Fakt
1	Materiale e shpenzime zyre	1,400	535
2	Shërbime nga të tretë (energji, ujë, postë, telefon, parkim etj.)	1,600	1,130
	Materiale dhe shërbime speciale	130	47
3	Shpenzime transporti + udhëtimi	1,000	387
4	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	400	248
5	Shpenzime të tjera speciale	170	70
	<b>TOTALI</b>	<b>4,700</b>	<b>2,417</b>



Performanca e realizimit të buxhetit në “Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera”, në bazë të analizës krahasimore plan-fakt, për 8-mujorin e vitit 2024, është në nivelin 50%. Theksojmë se niveli i realizimit të këtyre fondeve buxhetore kushtëzohet nga buxheti i kontraktuar pas zhvillimit të procedurave të prokurimit publik dhe një pjesë e shpenzimeve të planifikuara në 4-mujorin e dytë do të kryhen në periudhën e fundit të vitit. Gjithashtu, deri në fund të vitit, brenda buxhetit në shpenzime operative, do të kryhen pagesat për kamatëvonesat e shfaqura në sistemin tatimor, si rezultat i ndryshimeve të listëpagesave të sigurimeve shoqërore.

**III.3. Artikulli 231, “Shpenzime kapitale”**, buxheti i miratuar për këtë artikull, për vitin 2024, është 1,500 mijë lekë, buxhet i cili tejkalon kërkesën e institucionit, paraqitur kjo në dokumentin e Projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2024-2026, kërkesë e cila u kushtëzua nga përfundimi i mandatit kushtetues të institucionit dhe jetëgjatësia e asteve. Në detajimin mujor të vitit 2024, ky fond është shpërndarë në muajt maj dhe qershor, por meqenëse jemi në vitin e fundit të mandatit institucional nuk janë parashikuar blerje pajisje zyre, por vetëm është kryer dhe do të kryhet mirëmbajtja e pajisjeve dhe e mobilieve ekzistuese, sipas rastit.

#### **IV. Performanca jofinanciare**

Për sa i përket produkteve të realizuara me shpenzimet buxhetore për 8-mujorin, në përputhje me objektivin kryesor, mbrojtjen e interesit publik gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, respektimin e parimit të paanësisë, pavarësisë dhe procesit të rregullt ligjor, numri i çështjeve të njoftuara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë, brenda afateve ligjore, është 58 nga 92 çështje të planifikuara. Pjesa tjetër e çështjeve të planifikuara do të shqyrtohet deri në fund të vitit, periudhë e cila përkon me përfundimin e mandatit kushtetues të Komisionerëve Publikë. Pas shqyrtimit të vendimeve të njoftuara nga KPK, për periudhën janar-gusht 2024, Komisionerët Publikë kanë ankimuar 17 prej tyre, ndërsa për 41 vendime është vendosur mosankim. Produktet e planifikuara në investime për pajisje kompjuterike dhe mobilie, siç është paraqitur në tabelat e monitorimeve dhe u theksua edhe në analizën e shpenzimeve kapitale, nuk janë realizuar për periudhën raportuese.

#### **V. Përfundime**

Sa u trajtua në këtë raport, vlerësojmë se buxheti i planifikuar për periudhën 8-mujore është zbatuar brenda fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2024, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fushën e zbatimit të buxhetit të shtetit, në drejtimet kryesore të miratuara me vendimet e Mbledhjes së Komisionerëve Publikë dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik, si dhe në parimin e ligjshmërisë, ekonomicitetit, efikasitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve buxhetore, duke plotësuar nevojat më të domosdoshme për mallra dhe shërbime. Një pjesë e shpenzimeve të planifikuara do të rishikohen në vijim, në kuadër të ekonomizimit të fondeve buxhetore, duke kryer rishpërndarje të tyre ose përcaktimit të prioritetëve për plotësimin e nevojave më të domosdoshme dhe më emergjente.

**Nëpunës Zbatues**

Adelina Kastrati



**Nëpunës Autorizues**

Alketa Çel



ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

Periodha e Raportimit 8-2024

në/lekë

Emri i Grupit		Kodi i grupit										
Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë		63										
EMËRTIME		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti paraardhës 2023		Periodha raportuese		Periodha raportuese		Periodha raportuese	Periodha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periodhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %		
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (6-3)	(8)	(9)	10 (6-8)	11 (8/6)
<b>Shpenzimet sipas programeve buxhetore</b>												
Kodi i Programit	Emërtimi											
03360	Veprimtaria e komisionerit publik	128,745,942	100%	114,900,000	100%	116,900,000	100%	2,000,000	68,425,952	100%	48,474,048	59%
	<b>Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,08,22)</b>	<b>128,745,942</b>	<b>100%</b>	<b>114,900,000</b>	<b>100%</b>	<b>116,900,000</b>	<b>100%</b>	<b>2,000,000</b>	<b>68,425,952</b>	<b>100%</b>	<b>48,474,048</b>	<b>59%</b>
	<b>Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)</b>	<b>0.00</b>							<b>0.00</b>			
	<b>Totali Shpenzimeve të Ministrisë</b>	<b>128,745,942</b>							<b>68,425,952</b>			
<b>Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik</b>												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	116,347,131	90%	91,600,000	80%	98,200,000.00	84%	6,600,000	59,898,707.00	88%	38,301,293	61%
601	Sigurime Shoqërore	8,622,479	7%	9,600,000	8%	10,100,000.00	9%	500,000	6,080,101.00	9%	4,019,899	60%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,776,332	3%	12,200,000	11%	6,900,000.00	6%	-5,300,000	2,417,144.00	4%	4,482,856	35%
603	Subvencione	0	0%	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0%	0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0
605	Transferta Korente të Huaja	0	0%	0	0	0.00	0	0	0.00	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0%	-	-	200,000.00	0	200,000	30,000.00	0	170,000	15%
	<b>Nen-Totali Shpenzime Korrente</b>	<b>128,745,942.00</b>	<b>100%</b>	<b>113,400,000</b>	<b>99%</b>	<b>115,400,000</b>	<b>99%</b>	<b>2,000,000</b>	<b>68,425,952.00</b>	<b>100%</b>	<b>46,974,048.00</b>	<b>59%</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	0	0	0	0.00	0	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0%	1,500,000	1%	1,500,000	1%	0	0.00	0	1,500,000.00	0
	<b>Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>0.00</b>	<b>0%</b>	<b>1,500,000</b>	<b>1%</b>	<b>1,500,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0.00	0	-	0	0	0.00	0	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0.00	0	-	0	0	0.00	0	0.00	0
	<b>Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>-</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>
	<b>Totali Shpenzime Kapitale</b>	<b>0.00</b>		<b>1,500,000</b>	<b>0</b>	<b>1,500,000</b>	<b>1%</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor</b>	<b>128,745,942.00</b>	<b>100%</b>	<b>114,900,000</b>	<b>100%</b>	<b>116,900,000</b>	<b>100%</b>	<b>2,000,000</b>	<b>68,425,952.00</b>	<b>100%</b>	<b>48,474,048.00</b>	<b>59%</b>
	<b>Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)</b>	<b>0.00</b>							<b>0.00</b>			
	<b>Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh.jashte limitit)</b>	<b>128,745,942.00</b>		<b>114,900,000.00</b>		<b>116,900,000.00</b>		<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>		<b>48,474,048.00</b>	
	<b>Numri i punonjësve</b>	<b>27</b>		<b>30</b>		<b>30</b>			<b>27</b>			

NËPUNËS AUTORIZUES

Emri  
Firma  
Data

Alketa Çeli  
27.9.2024







ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

Periodha e Raportimit 8-2024

Kodi i Ministrisë	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periodha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore									
					230	231	600	601	602	603	604	605	606	Total
					Shpenzime Kapitale të Patrëpëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçinet	Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transfer. Korrente të Familjare dhe Individët	Total
63	01	Nga Buxheti	2024	Plani fillestar	0	1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000	0	0	0	0	114,900,000
63	01	Nga Buxheti	2024	Plani i rishikuar	0	1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000	0	0	0	200,000	116,900,000
63	01	Nga Buxheti	2024	Fakti	0	0	59,898,707	6,080,101	2,417,144	0	0	0	30,000	68,425,952
63	01	Nga Buxheti	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63		Total	2024	Plani fillestar	0	1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000	0	0	0	0	114,900,000
63		Total	2024	Plani i rishikuar	0	1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000	0	0	0	200,000	116,900,000
63		Total	2024	Fakti	0	0	59,898,707	6,080,101	2,417,144	0	0	0	30,000	68,425,952
63		Total	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2024		0	1,500,000	38,301,293	4,019,899	4,482,856	0	0	0	170,000	48,474,048
63		Realizimi ne %	2024		0	0	61%	60%	35%	0%	0%	0%	0%	59%



Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024



**Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"**

Periudha e Raportimit 8-20224

Kodi i Ministris	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 603	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	2024	Plani fillestar	0	1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000	0	0	0	0	114,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	2024	Plani i rishikuar	0	1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000	0	0	0	200,000	116,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	2024	Shpenzime faktike	0	0	59,898,707	6,080,101	2,417,144	0	0	0	0	68,395,952
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63		Ndryshimi ne vlere absolute	2024		0	1,500,000	38,301,293	4,019,899	4,482,856	0	0	0	0	48,304,048
63		Realizimi ne %	2024		0	0	61%	60%	35%	0	0	0	0	59%
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2024	Plani fillestar	0	1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000	0	0	0	0	114,900,000
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2024	Plani i rishikuar	0	1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000	0	0	0	200,000	116,900,000
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2024	Shpenzime faktike	0	0	59,898,707	6,080,101	2,417,144	0	0	0	0	68,395,952
63		Total i Ministrisë/Institucionit	2024	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63		Numri i punonjesve në Total	2024	Plani fillestar				30						30
63		Numri i punonjesve në Total	2024	Plani i rishikuar				30						30
63		Numri i punonjesve në Total	2024	Numri faktik				27						27

<b>Nëpunës zbatues</b>	Emri	Adelina Kastrati	<b>Nëpunës Autorizues</b>	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024





Emri i Grupit		Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Riverësimit në sistemin e Drejtësisë				Kodi i grupit		63					
Emri i		Veprimtaria e Komisionerit Publik				Kodi i programit		3360					
EMËRTIME		Shpenzimet e Programit											
		Viti paraardhës 2023		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	Struktura e shpenzimeve në %			
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 ( 8/5)			
<b>Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik</b>													
Kodi i Programit	Emërtimi												
600	Paga	116,347,131.00	90%	91,600,000	80%	98,200,000	84%	6,600,000	59,898,707.00	88%	38,301,293	61%	
601	Sigurime Shoqërore	8,622,479.00	7%	9,600,000	8%	10,100,000	9%	500,000	6,080,101.00	9%	4,019,899	60%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,776,332.00	3%	12,200,000	11%	6,900,000	6%	-5,300,000	2,417,144.00	4%	4,482,856	35%	
603	Subvencione	0.00	0%	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0%	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0%	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0.00	0%	0	0%	200,000	0%	200,000	30,000.00	0	170,000	0	
	<b>Nëntotali Shpenzime Korente</b>	<b>128,745,942.00</b>	<b>100%</b>	<b>113,400,000.00</b>	<b>99%</b>	<b>115,400,000.00</b>	<b>99%</b>	<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>	<b>100%</b>	<b>46,974,048.00</b>	<b>59%</b>	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0%	1,500,000	1%	1,500,000	0	0	0.00	0	1,500,000	0	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>0.00</b>	<b>0%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0</b>	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
	<b>Totali i Shpenzimeve Kapitale</b>	<b>0.00</b>	<b>0%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0</b>	
	<b>Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit</b>	<b>128,745,942.00</b>	<b>100%</b>	<b>114,900,000.00</b>	<b>100%</b>	<b>116,900,000.00</b>	<b>100%</b>	<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>	<b>100%</b>	<b>48,474,048.00</b>	<b>59%</b>	
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	<b>Totali i Shpenzimeve të Programit</b>	<b>128,745,942.00</b>		<b>114,900,000.00</b>		<b>116,900,000.00</b>		<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>		<b>48,474,048.00</b>	<b>59%</b>	
<b>Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor</b>													
Artikulli	Emërtimi												
	<b>Totali i Shpenzime Korente</b>	<b>128,745,942.00</b>	<b>100%</b>	<b>113,400,000.00</b>	<b>99%</b>	<b>115,400,000.00</b>	<b>99%</b>	<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>	<b>100%</b>	<b>46,974,048.00</b>	<b>59%</b>	
Kodi i produktit	Emertimi												
96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	128,745,942.00	100%	113,400,000.00	99%	115,400,000.00	99%	2,000,000.00	68,425,952.00	100%	46,974,048.00	59%	
	<b>Totali Shpenzime për Investime</b>	<b>432,000.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0.00</b>	
Kodi i produktit	Emertimi												
18AB202	Blerje Licensash							0	0.00	0	0	0	
M630001	Blerje Pajisje	432,000.00	0%	650,000	1%	650,000	1%	0	0.00	0	650,000	0	
M630008	Rikonstruksione							0	0.00	0	0	0	
M630013	Blerje pajisje kompjuterike			850,000	1%	850,000	1%	0	0.00	0	850,000	0	
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</b>	<b>432,000.00</b>	<b>0%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>1%</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>1,500,000.00</b>	<b>0.00</b>	
Kodi i produktit	Emertimi												
	<b>Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
Kodi i produktit	Emertimi												
Kodi i produktit	Emertimi												
	<b>Totali i Shpenzimeve të Programit</b>	<b>129,177,942.00</b>		<b>114,900,000.00</b>		<b>116,900,000.00</b>		<b>2,000,000.00</b>	<b>68,425,952.00</b>		<b>48,474,048.00</b>	<b>59%</b>	



Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati		Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli	
	Firma				Firma		
	Data	27.9.2024			Data	27.9.2024	



RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 8-2024



KODI i Ministrisë	KODI i Departamentit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	ërtimi i Kapitullit	Periudha e Raportimit	Buxheti	Artikujt buxhetore	230	231	600	601	602	603	604	605	606	Total
					Periodike /Vjetore			Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subvecinet	Të Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	Total
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	01	Nga Buxheti	2024	Plani fillestar			1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000				0	114,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	01	Nga Buxheti	2024	Plani i rishikuar			1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000				200,000	116,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	01	Nga Buxheti	2024	Fakti		0	59,898,707	6,080,101	2,417,144					30,000	68,425,952
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik	01	Nga Buxheti	2024	Angazhime		0	0	0	0	0				0	0
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik		Total	2024	Plani fillestar			1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000				0	114,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik		Total	2024	Plani i rishikuar			1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000				200,000	116,900,000
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik		Total	2024	Fakti		0	59,898,707	6,080,101	2,417,144					30,000	68,425,952
63	03360	Veprimtaria e komisionerit publik		Total	2024	Angazhime		0	0	0	0	0				0	0
63	03360	Ndryshimi ne vlere absolute			2024				1,500,000	38,301,293	4,019,899	4,482,856	0	0	0	170,000	48,474,048
63	03360	Realizimi ne %			2024				0%	61%	60%	35%				0%	59%

Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024





Emri i Grupit		Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtësisë			Kodi i grupit			63									
Emri i		Veprimtaria e komisionerit publik			Kodi i programit			3360									
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Njësia matëse	Viti paraardhës			Periudha Raportuese			Periudha Raportuese			Periudha Raportuese			Deviacioni i Kostos për Njësi		
			Sasia Faktike (Viti paraardhës)	Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës)	Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit Filleshtar Vjetor)	Shpenzimet (sipas planit Filleshtar Vjetor)	Kosto për Njësi (sipas planit Filleshtar të vitit)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (në rfund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike /në fund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike n/ë fund të vitit korent)	13=(12)-(3)	14=(12)-(6)	15=(12)-(9)
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)			
<b>Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit</b>																	
96304AA	Numer Çeshtjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	numër	126	128,745,942	1,021,793	86	113,400,000	1,318,605	92	115,400,000	1,254,348	58	68,425,952	1,179,758	157,965	-138,847	-74,590
M630002	Pajisje, mobilie	sete pune	0	-	-	3	650,000	216,667	3	650,000	216,667	0	0	0	0	-216,667	-216,667
M630013	Blerje pajisje kompjuterike	sete pune	0	-	-	3	850,000	283,333	3	850,000	283,333	0	0	0	0	-283,333	-283,333
T	Total			-	-		114,900,000	1,818,605		116,900,000	1,754,348		68,425,952	1,179,758	157,965	-638,847	-574,590
<b>Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)</b>																	



Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çelji
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024



Aneksi 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve

Periudha e Raportimit 8-2024

Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Tipi i Buxhetit	Sasia	Artikujt buxhetore									
							Total	230	231	600	601	602	603	604	605	606
								Shpenzime Kapitale të Patrupezuara	Shpenzime Kapitale të Trupezuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçnet	Të tjera Transfer Korrente Brëndshme	Transfer. Korrente të Huaja	Transfero për Buxhetet Familjare dhe Individët
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	96304AA	Numer Çeshtjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Plani fillestar	86	113,400,000			91,600,000	9,600,000	12,200,000				
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	96304AA	Numer Çeshtjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Plani i rishikuar	92	115,400,000			98,200,000	10,100,000	6,900,000			200,000	
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	96304AA	Numer Çeshtjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Fakti	58	68,425,952			59,898,707	6,080,101	2,417,144			30,000	
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630002	Pajisje, mobilie	Plani fillestar	3	650,000		650,000							
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630002	Pajisje, mobilie	Plani i rishikuar	3	650,000		650,000							
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630002	Pajisje, mobilie	Fakti	0	0		0							
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Plani fillestar	3	850,000		850,000							
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Plani i rishikuar	3	850,000		850,000							
63	03320	Veprimtaria e komisionerit publik	M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Fakti	0	0		0							
				Totali i shpenzime buxhetore	Plani fillestar		114,900,000		1,500,000	91,600,000	9,600,000	12,200,000			0	
				Totali i shpenzime buxhetore	Plani i rishikuar		116,900,000		1,500,000	98,200,000	10,100,000	6,900,000			200,000	
				Totali i shpenzime buxhetore	Fakti		68,425,952		0	59,898,707	6,080,101	2,417,144			30,000	



Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024





Aneksi 3.2 Deviacioni kostos për njësi në vite

Line Ministry	Program Code	Program Meaning	KPI Target Periodicit	Output Code	Output Meaning	Type Title	2021	2022	2023	2024
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Target Qty	140	160	130	86
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Planned Cost	74,350,000	73,728,000	88,900,000	113,400,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Unit Cost (Planned)	531,071	460,800	683,846	1,318,605
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve			-70,271	223,046	634,758
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Revised Qty	140	160	130	92
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Revised Cost	70,350,000	76,235,000	129,900,000	115,400,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Unit Cost (Revised)	502,500	476,469	999,231	1,254,348
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i planit të rishikuar për njësi gjatë viteve			-26,031	522,762	255,117
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Actual Qty	171	109	126	58
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Actual Cost	68,776,301	76,234,276	128,745,942	68,425,952
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		96304AA	Numer Çeshtjesh te njoftuara nga KPK, te shqyrtuara nga Komisioneret Publike brenda afateve ligjore	Unit Cost (Actual)	402,201	699,397	1,021,793	1,179,758
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i kostos faktike për njësi gjatë viteve			297,196	322,396	157,965
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Target Qty	4	7	3	3
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Planned Cost	2,000,000	1,000,000	650,000	650,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Unit Cost (Planned)	500,000	142,857	216,667	216,667
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve			-357,143	73,810	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Revised Qty	0	7	3	3
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Revised Cost	0	600,000	650,000	650,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Unit Cost (Revised)	0	0	216,667	216,667
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Deviacioni i planit të rishikuar për njësi gjatë viteve			0	216,667	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Actual Qty	0	7	0	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Actual Cost	0	432,000	0	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630002	Blerje Pajisje	Unit Cost (Actual)	0	61,714	0	0
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i kostos faktike për njësi gjatë viteve			61,714	-61,714	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Target Qty	5	2	3	3
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Planned Cost	2,000,000	1,000,000	850,000	850,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Unit Cost (Planned)	400,000	500,000	283,333	283,333
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i planit fillestar për njësi gjatë viteve			100,000	-216,667	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Revised Qty	0	0	3	3
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Revised Cost	0	0	850,000	850,000
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Unit Cost (Revised)	0	0	283,333	283,333
	3360	Veprimtaria e komisionerit publik			Deviacioni i planit të rishikuar për njësi gjatë viteve			0	283,333	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Actual Qty	0	0	0	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Actual Cost	0	0	0	0
63	3360	Veprimtaria e komisionerit publik		M630013	Blerje pajisje kompjuterike	Unit Cost (Actual)	0	0	0	0
					Deviacioni i kostos faktike për njësi gjatë viteve			0	0	0

Nëpunës zbatues	Emri	Adelina Kastrati	Nëpunës Autorizues	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024





ANEKSI nr.4 Raporti i realizimit të treguesve të performances së programit

Periudha e Raportimit 8-2024

Emri i Grupit	Veprimtaria e Mbikqyrjes dhe Rivlerësimit në sistemin e Drejtesisë	Kodi i Grupit	63						
Emri i Programit	Veprimtaria e komisionerit publik	Kodi i Programit	3360						
<b>Qëllimi i politikës së programit</b>	Procesi i Rivlerësimit të gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka për qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të drejtës, pavaresinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi								
<b>Treguesit e performancës në nivel qëllimi</b>				<b>Treguesit e performancës/Produktet:</b>					
<b>Kodi i treguesit</b>	<b>Emërtimi i treguesit</b>	Tregues me bazë gjinore (PO)	Njësia matëse	Fakti i Vitit Paraardhës	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Fakti i Periudhës/progressive	Ndryshimi (Plan - Fakt)	% e realizimit
<b>Objektivat e politikës së programit</b>									
<b>Objektivi</b>	Mbrotjtja e interesit publik gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, respektimi i parimit të paanësisë dhe pavaresisë, procesit të rregullt ligjor, transparencës dhe frymës së bashkëpunimit ndërmjet dy komisioneve publike, Operacionit Nderkombëtar të Monitorimit dhe institucioneve të tjera.								
<b>Produktet</b>									
<b>Kodi i treguesit</b>	<b>Emërtimi i treguesit</b>								
96304AA	Numer Çështjesh të njoftuara nga KPK, të shqyrtuara nga Komisionerët Publikë brenda afateve ligjore		Numer	126	86	92	58	34	63%
			lekë	128,745,942	113,400,000	115,400,000	68,425,952	46,974,048	59%
M630002	Pajisje, mobilie		sete	0	3	3	0	3	
			lekë	0	650,000	650,000	0	650,000	0
M630013	Blerje pajisje kompjuterike		sete	4	3	3	0	3	
			lekë	0	850,000	850,000	0	850,000	0

<b>Nëpunës zbatues</b>	Emri	Adelina Kastrati	<b>Nëpunës Autorizues</b>	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2024		Data	27.9.2024

